	4		Shpenzime nga operacionet e shkembimit (diferenca negative te kursit te kembimit)
	5		Shpenzime financiare te shtyra
	6		Shpenzime qe lidhen me Shitjen/Likuidimin e asetëve
		10	Nxjerrje jashte perdorimit e Aktiveve Afatgjata Materiale
		1	Nxjerrja e Aseteve perkohesisht jashte perdorimit e AAM
		2	Asgjesimi i Aseteve
		20	Shpenzime qe lidhen me shitjen e AAM
		30	Shpenzime qe lidhen me shitjen e AAJM
		40	Shpenzime te tjera qe lidhen me shitjen/azgjesimin e asetëve
	7		Shpenzime per rivleresimin e asetëve
		10	Shpenzime nga rivleresimi i AAM
		20	Shpenzime nga rivleresimi i AAJM
		30	Shpenzime nga rivleresimi i instrumentave financiare
		40	Shpenzime te tjera rivleresimi
	9		Shpenzime te tjera Financiare dhe Jo-Operative
		10	Shpenzime per Dhurime
		20	Amortizimi I asetëve te dhena me qera
		30	Shpenzime per periudhat e meparshme

	90		Shpenzime te tjera Financiare dhe Jo-Operative
69			Shpenzime te Jashtezakonshme
7			Te Ardhat
70			TE ARDHURAT NGA SHITJA
	1		Te ardhurat nga Shitja e Produkteve
	10		Te ardhura nga Shitja e Energjise Elektrike
		1	Te ardhura nga shitja ne tregun e rregulluar
		2	Te ardhura nga shitja ne tregun e parregulluar
	20		Te ardhura nga Shitja e Energjise Termike
	90		Te ardhura nga Shitja e Produkteve nga aktivitetet e parregulluara
	2		Te ardhurat nga Shitja e Mallrave
	3		Te ardhurat nga Shitja e Sherbimeve
	10		Te ardhura nga Shitja e Kapaciteteve Disponibel
		1	Te ardhura nga shitja e Kapaciteteve Disponibel ne tregun e rregulluar
		2	Te ardhura nga shitja e Kapaciteteve Disponibel ne tregun e parregulluar
	20		Te ardhura nga Shitja e Sherbimeve te Sistemit
	90		Te ardhura nga Shitja e Sherbimeve te Pa-rregulluara
	4		Te ardhura te Shtyra
	10		Te ardhura te Shtyra nga aktivitetet e rregulluara
	20		Te ardhura te shtyra nga aktivitetet e parregulluara
	5		Te ardhura nga Subvencionet dhe Grantet
	6		Te ardhura nga Asgjesimi dhe Paaftesi Paguese)
	9		Te ardhura nga Shitjet e tjera
	10		Te ardhura nga asetet e dhena me qira
	20		Te ardhura nga gjobat dhe penaltetet
	30		Te ardhura nga detyrimet e falura
	40		Te ardhura te tjera nga Shitjet
		1	Te ardhura nga periudhat e meparshme
		2	Te ardhura te tjera nga aktiviteti
	90		Te ardhura te tjera nga aktivitetet e parregulluara
72			TE ARDHURA FINANCIARE
	1		Te ardhura nga Interesat
	10		Te ardhura nga Interesat per llogarite bankare
	20		Te ardhura nga Interesat per depozitat

	30	Te ardhura nga Interesat per huadhenie
	40	Te ardhura te tjera nga Interesat
2		Te ardhura nga Pjesmarrjet
3		Te ardhura nga Operacione me instrumenta financiare
4		Te ardhura nga Operacione me Valute (diferenca pozitive kembimi)
5		Te ardhura Financiare te vonuara
6		Te ardhura nga Tepricat e Aseteve
7		Te ardhura nga Shitjet/Asgjesimi i Aseteve
	10	Te ardhura nga Asgjesimi i AAM
	20	Te ardhura nga Shitjet e AAM
	30	Te ardhura nga Shitjet e AAJM
	40	Te ardhura te tjera nga Shitjet/ Asgjesimi i Aseteve
8		Te ardhura nga Rimatja e Aseteve
	10	Te ardhura nga Rimatja e AAM
	20	Te ardhura nga ndryshimet ne vlere te inventareve
9		Te ardhura te tjera Financiare dhe jo-operative
	10	Te ardhura nga Subvencionet dhe Grantet
	20	Te ardhura nga detyrimet e falura
	90	Te ardhura te tjera te ndryshme jo-operative
79		Te ardhura te tjera te Jashtezakonshme
9		LLOGARI JASHTE BILANCIT
91		AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE TE TE TRETEVE
92		AKTIVE FINANCIARE TE TE TRETEVE
93		INVENTARE TE TE TRETEVE
94		DEBITORE TE MUNDHEM (ME KUSHT))
95		KREDITORE TE MUNDHEM (ME KUSHT)
96		AKTIVE TE VETA QE NUK KANE LIDHJE ME BIZNESIN
97		DETYRIME TE VETA QE NUK KANE LIDHJE ME BIZNESIN
98		Llogari te tjera Aktivesh Jashte Bilancit
99		Llogari te tjera Detyrimesh Jashte Bilancit

Shtojca 1

UDHEZIM MBI LISTEN E LLOGARIVE PER QELLIME TE RREGULLIMIT TE GJENERUESVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE

1. HYRJE

Ky udhezim eshte ndertuar dhe organizuar ne menyre qe te siguroje informacionin e kerkuar per qellim te llogarive rregullatore. Mbartesit e informacionit ne kete rast jane Bilanci dhe Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve. Informacioni ne keto pasqyra eshte kategorizuar dhe strukturuar ne menyre qe te mundesohet rregullatori per monitorimin dhe kontrollin ne menyre sa me objektive te gjendjes se parametrave dhe kerkesave te percaktuara ligjesisht.

Jane paraqitur kode llogarish tre- kater- dhe gjashte-shifrore, duke perfshire nivelet korresponduese analitike. Karakteristikat e detajuara te llogarive mbajne informacionin e duhur per qellimet rregullatore dhe ne perputhje me informacionin e kerkuar si nje ceshtje prioritare per rregullatorin.

Tabela ne vijim ilustron grupet e llogarive qe regjistrohen ne listen e llogarive te artikujve te pasqyres se bilancit.

Aktivet	Llogarite	Aktivitetet e Licensuara	Aktivitetet e palicensuara.
Aktive te qendrueshme			
Toka,ndertesa dhe pajisje	Grupi 20, Grupi 24		
Aktive te patruzezuara	Grupi 21, Grupi 24		
Investime, huadhenie dhe qera	Group 22		
Postponed tax assets (takse e shtyre mbi aktivet)	Llogaria 497		
Aktivet Qarkulluese			
Inventaret	Grupi 30		
Kerkesa per arketim dhe aktive te tjera.	Grupet 40, 41, 42, 44, 45, 49		
Huadhenie dhe qera	Grupi 22, Llogaria 725		
Likuiditete dhe vlera te tjera arke	Grupet 50, 51		
Aktive gjithsej			
KAPITALI I VET DHE DETYRIMET			
Kapitali dhe rezervat			
(Aksione) kapital	Grupi 10		
Reservat	Grupi 11		
Rezultati Financiar	Grupi 12		
Financime	Grupi 13		
Detyrime Afatgjata			
Huara	Grupi 15		
Detyrime korente			
Furnitore per blerje, sherbime dhe detyrime te tjera korente.	Grupet 40, 41, 42, 44, 45, 49		
Shteti- tatime dhe taksa (te shtyra)	Llogaria 497		
Borxhe	Grupi 15		
Gjithsej Detyrimet			
Gjithsej kapitali dhe detyrimet			

1.1.1. 1. Kategorite dhe struktura e Atimeve te Qendrueshme te Trupezuara

Kategorizimi dhe operacionet financiare do te formalizohen ne perputhje me IFRS 16 (Standartin Nderkometar te Raportimit Financiar nr. 16), duke perfshire Pronen, Impiantin dhe Paisjet me detajime te metejshme per qellime financiare rregullatore.

Atimeve te qendrueshme te trupezuara do te raportohen me vleren e perfimit minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nga demtimi, me “vleren e drejte” te tyre.

Pjesa e amortizueshme e prones, impiantit ose pajisjeve (makinerite, pajisjet, aparatura) do te shperndahet ne menyre sistematike gjate gjithes jetes se dobishme te aktivitetit.

Metoda e perdorur e amortizimit do te reflektoje modelin sipas te cilit shoqeria konsumon perfitimet ekonomike te aktivitetit.

Amortizimi per cdo periudhe do te njihet si shpenzim, me perjashtim kur ai eshte perfshire ne vleren e mbajtur te nje aktivi tjetër.

Perfitimet ekonomike te materializuara ne nje aktiv konsumohen nga ndermarrja, vlere e mbajtur e aktivitet pakesohet ne menyre qe te reflekteje kete konsum, dhe nje shpenzim amortizimi eshte kryer (akumuluar). Nje pagese amortizimi (depreciation charge) do te kryehet edhe nese vlere e aktivitet do te tejkaloj vlere e tij te mbajtur.

Ndermarrja konsumon perfitimin ekonomik te materializuar ne nje prone te vetme, impiant ose pajisje kryesisht nepermjet perdorimit te aktivitet. Megjithate, faktore te tjere si vjeterimi teknik, si dhe konsumi kur aktivi qendron pa pune, shpesh rezultojne ne pakesim te perfitimit ekonomik qe mund te pritej te arrihej nga aktivi.

Faktoret ne vijim do te konsiderohen percaktues te jetes se dobishme te aktivitet:

1. Perdorimi i pritshem i aktivitet nga ndermarrja; perdorimi vleresohet nga referimi ne kapacitetin e pritur te aktivitet ose produktin fizik.
2. Vjeterimi i pritshem fizik, i cili varet nga faktoret operacionale dhe programet e riparimit dhe mirembajtjes se ndermarrjes, dhe kujdesi e mirembajtja e aktivitet kur nuk perdoret.
3. Vjeterimi teknik.
4. Kufizimet ligjore ose te tjere te ketij lloji ne perdorimin e aktivitet.

Jeta e dobishme e aktivitet percaktohet e shprehur ne termat e dobishmerise se pritshme te aktivitet per ndermarrjen. Jeta e dobishme e aktivitet mund te jete me e shkurter se jeta e tij ekonomike. Vleresimi i jetes se dobishme te nje prone, impianti ose pajisjeje eshte ceshtje gjykimi bazuar ne eksperiencen e ndermarrjes me aktive te ngjashme.

Toka dhe ndertesat jane aktive te ndashme dhe per qellime kontabel do te konsiderohen ne vecanti, edhe nese jane perftuar se bashku.

Toka ka jete te dobishme te pakufizuar dhe nuk i llogaritet amortizim.

Jeta e dobishme e aktiveve percaktohet dhe perfshihet ne planin e amortizimit te ndermarrjes qe pergatitet per te gjitha aktivitet dhe aprovet nga drejtimi I kompanise.

Shuma e amortizueshme e cdo aktivi percaktohet pasi zbritet vlere e mbetur e aktivitet. Praktikisht, vlere e mbetur e aktivitet ne shume raste nuk eshte e perfillshme, dhe prandaj eshte e parendesishme per llogaritjen e vleres se amortizueshme.

Metoda e amortizimit e aplikuar per shperndarjen sistematike te vleres se amortizueshme te aktiveve pergjate jetes se dobishme te tyre eshte ajo lineare. Metoda qe do te aplikohet per cdo aktiv do te zgjidhet mbi bazen e modelit te pritshem te perfitimit ekonomik dhe do te aplikohet ne menyre te vazhdueshme neper te gjitha periudhat perkatese, me perjashtim te rasteve kur ka ndryshim ne modelin e pritshem te perfitimeve ekonomik per aktivitet respektive.

Aktivitet e qendrueshme do te amortizohen ne perputhje me metoden lineare.

Shpenzimet e interesave te borxheve per financimin e ndertimit (krijimit) te aktiveve te qendrueshme te trapezuara do te raportohen si shpenzime te periudhes perkatese.

Mirembajtja, riparimi, permiresimet e vogla dhe pajisjet minore do te raportohen ne Pasqyren e te Ardhurave per periudhen perkatese. Vlere e modernizimeve dhe permiresimeve te rendesishme do te perfshihen ne vleften e mbajtur te aktivitet, nese mendohet qe kompania te do te marre perfitime ekonomike te ardhshme qe tejkalojne ato te parashikuara per aktivin e vecante. Modernizimet dhe permiresimet e rendesishme do te amortizohen per periudhen e dobishme te aktivitet perkates per te cilin jane kryer.

Shembuj te permiresimeve te cilat rezultojne ne rritje te perfitimeve te ardhshme ekonomike pershijne:

- a) Modifikim i nje elementi te impiantit per te zgjatur jeten e dobishme te tij, duke perfshire nje rritje te kapacitetit te tij;
- b) Permiresim i pjeseve te makinerive per te arritur permiresime thelbesore te cilesise se prodhimit; dhe
- c) Adoptimi i proceseve te reja te prodhimit per te mundesuar nje reduktim te rendesishem te kostove te meparshme te operimit.

Per qellime te rregullimit, aktivet e qendrueshme do te raportohen ne llogarite e zakonshme te Seksionit 2 “Llogarite e Aktiveve te Qendrueshme”, Grupit 20 “Aktivet e qendrueshme te Trupezuara”, te shenuara ne kode tre-shifrore. Nese kompania perkatese e prodhimit te energjise elektrike aplikon numerim ndryshe nga ai i paraqitur, atehere ajo duhet te paraqese informacionin e kerkuar ne formatin e paraqitur ne kete dokument.

1.2. 2Kategorite dhe struktura te Ardhurave Operative

Dispozitat e Standartit Nderkombetar te Kontabilitetit (IAS)18 te Ardhurat do do te aplikohen ne raportimin e te ardhurave nga transaksionet dhe ngjarjet ne vijim:

1. Shitja e produkteve dhe mallrave te perfunduara.
2. Kryerja e sherbimeve.
3. Perdorimi i asetve te ndermarrjes nga njesite e tjera, ku ky perdorim sjell interesa, pagesa per te drejtat dhe dividente.

Sherbimet mund te kryhen gjate nje periudhe ose me teper se nje periudhe. Disa kontrata per kryerje sherbimesh lidhen direkt me kontratat e ndertimit, per shembull per sherbimin e projektimit. Te ardhurat nga kontrata te tilla do te konsiderohen ne perputhje me kerkesat per kontratat e ndertimit.

Te ardhura quajme hyrjen bruto te perfitimeve ekonomike gjate periudhes, te gjeneruara ne procesin e veprimtarise se zakonshme te ndermarrjes, ku hyrjet ne fjale cojne ne rritje te kapitalit pervec rritjes nga kontributet e aksionereve.

Te ardhurat perfshijne vetem hyrjet bruto te perfitimeve ekonomike, ndersa shumet e arketuara per llogari te te treteve, te tilla si taksat mbi shitjen, taksat mbi mallrat dhe sherbimet dhe taksa e vleres se shtuar, nuk perfshihen ne perfitimet ekonomike te ndermarrjes dhe nuk cojne ne rritje te kapitalit. Prandaj ato perjashtohen nga te ardhurat.

Te ardhurat nga shitja e produkteve te gateshme do te njihen kurdo qe rreziket materiale dhe perfitimet nga pronesia e produkteve te gateshme transferohen tek bleresi.

Te ardhurat nga shitja e sherbimeve do te njihen mbi baze te shkalles se kryerjes se sherbimit te vecante te percaktuar nepermjet raportit ne perqindje te sherbimit te dorezuar ne momentin e dhene ndaj gjithë volumit te sherbimit qe pritet te dorezohet.

Te ardhurat nga interesi do te njihen sipas parimit te kohes se ndodhjes se tyre ne varesi te periudhes se mbetur dhe interesit efektiv per periudhen e maturimit ne rastet kur eshte vendosur qe keto te ardhura do t'i shtohen kompanise.

Struktura e Listes se Llogarive eshte detajuar me tej per qellime te llogarive rregullatore dhe permban nje klasifikim per raportim te perfshire ne Pasqyren e te Ardhurave te kompanise per qellime te mekanizmit rregullator.

3. SHPENZIMET PER AKTIVITETIN E RREGULLUAR PER QELLIME TE LLOGARIVE RREGULLATORE

Per qellime te mekanizmit rregullator eshte ndjekur nje metode per percaktimin e shpenzimeve sipas aktiviteve, duke perfshire prodhimin e energjise elektrike, sherbimet e sistemit dhe aktivitetet e parregulluara.

Cdonjeri nga keto aktivite ka karakterisika specifike qe lejojne secilin te jete i ndare edhe per sa i takon llogarive. Kjo ben te mundur monitorimin e tyre, matjen dhe kontrollin nepermjet mekanizmiave te transaksioneve kontabile per nevojat e autoritetit rregullator.

Ne te njejten kohe, konsolidimi i aktiviteve te rregulluara mundeson gjithashtu mulimin e pergjithshem te procesit dhe menaxhimit te tij ne perputhje me politiken kombetare te ndjekur per energjine.

Me qellim qe te vecohen veprimtarite e licensuara (prodhimi i energjise elektrike dhe ngrohjes dhe sherbimet e sistemit), kompanite e prodhimit te energjise elektrike duhet te kryejne sa vijon:

1. Te identifikojedhe rregjistrojne ne librat e llogarive vecmas shpenzimet per aktivitetet e parregulluara.
2. Te masin shpenzimet direkte sipas llojit te aktivitetit te rregulluar. (Skema te llogaritjes sipas aktiviteve dhe objekteve mund te zbatohen gjate percaktimit te kostove te energjise elektrike, te ngrohjes dhe sherbimeve te sistemit.)
3. Te identifikojne shpenzimet indirekte te prodhimit dhe te propozojne mekanizma te arsyetuar per shperndarjen e tyre.
4. Te percaktojne shpenzimet per cdo aktivitet te rregulluar pergjate gjithë zinxhirit te prodhimit, me qellim qe te ndertojne strukturen e tyre te brendshme. (Shpenzimet per kapacitet dhe shpenzimet per energji do te identifikohen gjate percaktimit te kosos se energjise elektrike.)

1.3. 3.1 Percaktimi i aktiviteve te rregulluara dhe struktura e tyre e brendshme

ERE rregullon aktivitetet qe kane lidhje me prodhimin e energjise dhe sherbimet e sistemit.



Subjektet e niveleve kyc te monitorimit te aktiviteve qe kane lidhje me Prodhimin e Energjise Elektrike dhe Sherbimet e Sistemit jane:

- Shpenzimet per operacione kryesore, perfshire:
 - Shpenzimet per lende djegese
 - Shpenzimet per sherbime
 - Shpenzimet per riparime
- Shpenzimet per operacione jo-kryesore, perfshire:
 - Shpenzimet per lende djegese
 - Shpenzimet ne garazhe dhe qendrat e sherbimit
 - Shpenzimet ne punishtet e riparimit
 - Shpenzimet per laborator dhe qendrat kerkimore
 - Shpenzimet per aktivitete te jera jo-kryesore
- Shpenzimet per kerkim dhe zhvillim
- Shpenzimet administrative dhe te pergjithshme
- Shpenzime per ndertime kapitale

1.4. 3.2 Percaktimi i shpenzimeve sipas elementeve ekonomike

Llogarite per raportimin e shpenzimeve sipas elementeve ekonomike grupohen ne nen-grupin 60, “Shpenzimet sipas elementeve ekonomik,” te Grupit 6.

Llogarite jane operacionale dhe mbahen me xhiron neto, me qellim qe te japin te dhena per te plotesuar Pasqyren e te Ardhurave. Ndryshimet ne sasiste e rregjistruara fillimisht (materiale e kthjera te papedorura ne prodhim, pagesat/kompensimet jo-korrekte, etj.) do te behen vetem nepermjet hyrjeve te zbritshme.

Raportimi analitik nen llogarite e Grupit 60 do te organizohet ne varesi te informacionit te nevojshem per qellime monitorimi sipas objekteve te monitorimit (shpenzimet per lende djegese, shpenzimet for sherbime, shpenzimet per riparime, shpenzimet per operacione jo-kryesore, shpenzimet per kerkime per zhvillim, shpenzimet per ndertime kapitale, shpenzime administrative dhe te pergjithshme).

Ne fund te periudhes raportuese llogarite e Grupit 60 do te mbyllen (kreditoohen) kundrejt debitimit te llogarive te Grupit 61 Shpenzime Operative dhe Grupit 207 Shpenzime per perftimin e aktiveve te Qendrueshme te trupezuara.

Eshte e domosdoshme te theksohet se shpenzimet per materiale, sherbime, amortizimim, paga dhe sigurime sociale, para se te futen ne llogarite e Grupit 60, do te klasifikohen sipas funksioneve per rregjistrimin ne vijim ne llogarite e Grupit 61 “Shpenzime operative”. Kjo mund te kryhet ne dy menyra: (a) nepermjet niveleve shtese me analitike te llogarive ne Grupin 60; ose (b) nepermjet rregjistrimit te njekohshem te shpenzimeve respektive (te reflektuar ne dukumentat kryesore te analizuar) ne kredi te llogarive te Grupit 60 dhe ne debi te llogarive respektive te Grupit 61. Kjo Liste Rregullatore e Llogarive ka adoptuar menyren e dyte me qellim te thjeshtezimit te raportimit analitik.

Llogaria 606 Shpenzime te tjera per sherbime operimi do te raportoje te gjitha shpenzimet e operimit qe nuk jane rregjistruar ne llogari te tjera te Grupit 60. Llogaria do te mbyllet me llogarine respektive te Grupit 61.

1.5. 3.3 Percaktimi i shpenzimeve sipas aktiviteve

Secili nga artikujt e shpenzimeve do te detajohet me tej ne nivelin qe eshte subjekt i monitorimit dhe kontrollit nga autoriteti rregullator duke pasur lidhje direkte ose indirekte me karakteristikat e

rregulluara te kompanive te prodhimit te energjise elektrike. Ne vijim po japim zonat e mundshme te ndodhjes (occurrence) shpenzimeve indirekte te prodhimit:

- Sipas aktiviteve kryesore te licensuara (llog 611).
- Sipas aktiviteve jo-kryesore (llog 612).
- Sipas organizimit te pergjithshem administrativ te procesit te prodhimit (llog 614).

Nga ana tjeter, ne baze te natyres se tyre, shpenzimet direkte dhe indirekte te prodhimit mund te paraqiten si:

- Kosto relativisht fikse.
- Kosto variable.

Per shembull, relativisht fikse jane kostot e amortizimit dhe mirembajtjes se nderteses dhe pajisjeve. Si kosto pergjithesisht variable do te klasifikohen materialet ndihmese, shpenzimet per pagat e punonjesve te perfshire ne punimet e pergjithshme te prodhimit, etj.

Vecorite e aktivitetit te prodhimit te energjise elektrike parapercaktojne ekzistencen e shpenzimeve qe jane te perbashketa per te tre aktivitetet e licensuara, duke perfshire prodhimin e energjise elektrike, prodhimin e ngrohjes dhe sigurimin e serbimeve te sistemit. Keto kosto te perbashketa te prodhimit do t'i alokohen veprimtarive mbi baza racionale dhe te qendrueshme. Alokimi do te bazohet mbi analizat e procesit te prodhimit.

Dy grupet e tjera te shpenzimeve qe jane subjekt i alokimit jane shpenzimet per veprimtarite jo-kryesore dhe shpenzimet administrative-manaxheriale. Keto shpenzime do t'i alokohen aktiviteve te rregulluara dhe te pa-rregulluara, ku baza per alokim do te jete pjesa relative e te ardhurave nga aktivitetet perkatese kundrjet totalit te te ardhurave nga aktivitetet qe kryen kompania.

Llogarite per raportimin e shpenzimeve sipas veprimtarive jane grupuar nen nen-grupin 61, "Shpenzime per operacinet," te Grupit 6.

Ky grup, per qellim te berjes se tarifes, perfshin llogari per raportimin e shpenzimeve sipas aktiviteve perkatese te licensuara (gjenerim i energjise elektrike dhe ngrohjes dhe sherbimet e sistemit), si dhe shpenzimet e shtyra/prapambetura, shpenzimet e organizimit dhe drejtimitt dhe shpenzimet per shitjen e produkteve te gatshme.

Llogaria 611 Shpenzimet per prodhimin e energjise elektrike dhe sherbimet e sistemit

Llogaria 611 sherben per raportimin e te gjithe shpenzimeve per prodhimin e energjise elektrike, qe perfshijne (a) shpenzimet qe formojne koston e energjise elektrike te prodhuar, te cilat perfshijne koston e materialeve, sherbimeve, amortizimin, pagat, sigurimin shoqeror e shendetesor dhe trajtimin e punonjesve dhe shpenzimet e tjera qe kane lidhje me aktivitetin kryesor te prodhimit (direkt nga nen-llogarite e Grupit 60) dhe shpenzimet per aktivitetet jo kryesore (te cilat formohen paraprakisht ne llogarine 612) dhe shpenzimet per riparime (te cilat formohen paraprakisht ne llogarine 617); b) shpenzimet per organizim dhe drejtimin (te cilat formohen paraprakisht ne llogarine 614); dhe, c) shpenzimet per shitje (te cilat formohen paraprakisht ne llogarine 615).

Raportimi analitik sipas llogarive 611 X0 do te organizohet sipas aktiviteve te licensuara: prodhimi i energjise elektrike dhe kryerja e sherbimeve te sistemit. Shpenzimet per keto aktivite formohen nepermjet shperndarjes te te gjithe grupeve te shpenzimeve si vijon: a) kostot direkte do te shperndahen duke perdorur faktore te percaktuar ne menyre analitike lidhur me vecorite fizike te procesit te prodhimit, b) Kostot indirekte do te alokohen duke perdorur faktore te justifikuar mbi baza llogarie ose bazuar mbi kostot indirekte.

Shpenzimet per prodhimin e energjise elektrike do te ndahen me tej ne kosto te dy niveleve: a) shpenzime per energjine elektrike te shitur ne tregun e rregulluar dhe shpenzime per energjine elektrike te shitur ne tregun e pa-rregulluar; dhe b) shpenzime qelidhen me kapacitetet disponibel dhe shpenzime per prodhimin e energjise.

Llogaria 611 do te kreditohet me koston e sherbimeve kundrej debitimin te llogarive te grupit 123 “Fitimi dhe humbja nga veprimtarite e rregulluara”.

Llogaria 612 Shpenzimet per aktivitetet jo-kryesore

Llogaria 612 sherben per te raportuar shpenzimet qe kryhen ne aktivitetet jo-kryesore te ndermarrjes. Aktivitete jo-kryesore te ndermarrjes do te jene ato te cilat jane pjese integrale e aktiviteve kryesore dhe qe kane per qellim t’u sherbejne ketyre te fundit. Te tilla mund te jene veprimtarite e punishteve mekanike te riparimit, garazhet dhe qendrat e sherbimit per njesite e transportit, laboratoret dhe qendrat kerkimore, etj.

Raportimi analitik sipas llogarise 612 do te organizohet sipas aktiviteve jo-kryesore dhe sipas artikujve qe lidhen me aktivitetet kryesore te ndermarrjes. Te gjitha shpenzimet ne aktivitetet jo-kryesore te cilet mund te rrjedhin direkt (ose kane origjinen nga) nga lloji respektiv i aktivitetit te licensuar do te rregjistrohen ne nen-llogarite perkatase te llogarise 612. Ne rastet kur nuk eshte e mundur ti ngarkojme ato ne nje lloj te vecante te aktivitetit kryesor, shpenzimet e aktiviteve jo-kryesore do te alokohen nepermjet faktoreve te alokimit ne menyre te ngjashme me alokimin e shpenzimeve te llogarise 611.

Llogaria 613 Shpenzimet e shtyra (Deferred)

Llogaria 613 sherben per raportimin e shpenzimeve te bera gjate periudhes raportuese por qe i perkasin periudhave te ardhshme.

Kur reflektohen shpenzimet ne debi te llogarise 613 do te percaktohet gjithashtu periudha per kryerjen e pageses se tyre.

Llogaria 613 do te debitohet duke bere hyrjet ne llogarite respektive te bilancit financiar.

Llogaria 614 Shpenzime te organizimit dhe drejtimit

Llogaria 614 sherben per raportimin e shpenzimeve qe kane lidhje me menaxhimin e pergjithshem dhe funksionimin e ndermarrjes.

Raportimi analitik nen llogarine 614 do te organizohet vetem sipas llojeve te shpenzimeve, por nese grupimi i tyre mund te thjeshtezoje hyrjen e tyre sipas llojeve te aktiviteve te licensuara (gjenerim energjie elektrike, gjenerim ngrohjeje dhe sigurim i sherbimeve te sistemit), ndermarrja mund te perdori grupim te perkohshem.

Llogaria 614 do te debitohet me shpenzimet per organizim dhe menaxhim kundrejt kreditimit te llogarive te grupit 60 Shpenzime sipas elementeve ekonomike dhe do te mbyllet nen llogarite e grupit 61 nepermjet faktoreve te alokimit. Faktoret e alokimit te shpenzimeve per organizim dhe menaxhim mund te percaktohen mbi shume baza, per shembull, mbi baze te raportit kosto direkte/indirekte, raportit te shpenzimeve te amortizimit, raportit te shpenzimeve per pagat, raportit te te ardhurave, etj. ose mbi baze te konsideratave te tjera, per shembull, ne menyre te barabarta ose mbi baze raportesh te volumit te shitur te produktit perfundimtar, numrit te konsumatoreve, etj. Per cdo rast, ato duhet te propozohen nga i Licensuari dhe te justifikohen tek Rregullatori.

Llogaria 615 Shpenzimet per shitjen e produktit te gatshem

Llogaria 615 sherben per raportimin e shpenzimeve qe kane lidhje me shitjen e produkteve te gatshme dhe sherbimeve.

Raportimi analitik nen llogarine 615 do te organizohet sipas aktiviteve te licensuara: gjenerim energjie elektrike, gjenerim nxehtesie dhe sigurim i sherbimeve te sistemit. Normalisht, shpenzimet per shitjen e produkteve te gatshme jane lehtesisht te percaktueshme direkt tek aktivitetet respektive sipas nen-llogarive perkatase te llogarise 612. Ne raste te rralla, kurdo qe nje shpenzim i vecante per shitjen e produkteve te gatshme eshte i perbashket, ai do te alokohet dhe rregjistrohet ne nen-llogarite respektive

te llogarise 612 me nje faktor alokimi, ne menyre te ngjashme me alokimin e shpenzimeve nen grupin “Shpenzime per organizim dhe menaxhim”.

Llogaria 615 do te debitohet me kostot per shitjen produkteve te gatshme kundrejt kreditimit te llogarive te grupit 60 Shpenzime sipas elementeve ekonomike.

Llogaria 615 do te kreditohet ne mbyllje kundrejt debitit te llogarive te grupit 612.

Llogaria 617 Shpenzime riparimi

Llogaria 617 sherben per raportimin e shpenzimeve te riparimit.

Raportimi analitik nen llogarine 617 do te organizohet sipas llojeve te aktivitetit te licensuar nepermjet ndarjes se shpenzimeve per riparimet qe kane lidhje me operacionet administrative.

Shpenzimet e riparimit do te rregjistrohen sipas llojeve te aktiviteteteve te licensuara si vijon: a) ato shpenzime qe mund t'i ngarkohen direkt (ose kane origjine nga) llojeve respektive te aktivitetit te licensuar do te rregjistrohen ne nen-llogarite perkatese te llogarise 612; b) ato shpenzime qe nuk mund te ndiqen sipas llojeve respektive te aktivitetit te licensuar (nga nen-llogaria 617 40 Shpenzime riparimi te pa-shperndara qe kane lidhje me prodhimin e energjise dhe sherbimet e sistemit) do te futen ne nen-llogarie relevante te llogarise 612 me faktoret e alokimit, ne menyre te ngjashme me alokimin e shpenzimeve nen llogarine 611.

Llogaria 615 do te debitohet me shpenzimet per shitjen e produkteve te gatshme kundrejt kreditimit te llogarive te grupit 60 Shpenzime sipas elementeve ekonomike.

Llogaria 615 do te kreditohet ne mbyllje kundrejt debitimit te llogarive te grupit 612.

Llogaria 619 Shpenzime per aktivitetet e pa-rregulluara

Te gjitha shpenzimet per aktivitetet e pa-rregulluara do te futen ne llogarine 619.

2. SHTOJCE

Llogarite ne listen rregullatore te llogarive jane sistemuar sipas grupeve ne vijim, te koduar me numra 3-shifrore:

101 – 123	Kapitali
131 – 132	Grante
151 – 159	Borxhi
201 – 209	Aktive te Qendrueshme te Trupezuara
211 – 219	Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara
221 – 225	Investimet Afat-Gjata dhe Kerkesat per Arketim
230	Aktivet Financiare Afat-Gjata
242 – 249	Amortizimi
251 – 254	Provizione
261 – 262	Emri i Mire
301 – 310	Inventaret
401 – 404	Furnitoret dhe llogarite qe kane lidhje me furnitoret
411 – 416	Kliente dhe llogarite qe kane lidhje me klientet
421 – 426	Llogarite rregulluese me personelin dhe ortaket
441 – 445	Kerkesa per arketim nga mungesa, mashtrime dhe ceshtje gjyqesore
451 – 458	Llogari rregullimi me buxhetin, sigurimet shoqerore dhe agjensite qeveritare
491 – 499	Debitore dhe kreditore te ndryshem
501 – 519	Arka
511 – 515	Investimet afat-shkurtra
601 – 609	Shpenzimet sipas Elementeve Ekonomike
611 – 619	Shpenzimet Operative
621 – 629	Shpenzimet Financiare dhe te Tjera Jo-Operacionale
691 – 699	Shpenzime te Jashtezakonshme
701 – 709	Te Ardhura Operative
721 – 729	Te ardhura Financiare dhe Te tjera Jo-Operative
791 – 799	Te Ardhura te Jashtezakonshme
911 – 999	Llogarite Jashte bilancit

- a) Cdonjera nga keto llogari ka nen-llogari tre-shifrore.
- b) Ne disa raste, numrat jane kaluar me qellim qe te lejojne shtesa te mevoneshme ose te lejojne kordinim me te mire me sistemin e numerimit.
- c) Cdo Kompani e Prodhimit te Energjise mund te adoptoje per qellimet e saj nje sistem tjetër te numrave te llogarive ne rast se Sistemi Uniform i Llogarive do te paraqitet ne titujt pershkruar te librit te pergjithshem te llogarive dhe ne ditare te ndryshem dhe ne dokumenta origjinale. Nese

Kompania e Prodhimit te Energjise Elektrike perdor numra te ndryshem llogarish, ajo duhet te kete ne dispozicion te gateshme nje liste te ketyre numrave te llogarive dhe nje sistem reference (sistem per per pershtatjen e tyre) te ketyre numrave te llogarive me numrat e llogarive te parashikuara ne Listen e Unifikuar te Llogarive (USOA). Gjithashtu, regjistrimet e Kompanise se Prodhimit te Energjise Elektrike do te lejojne analizat sipas llogarive te USOA dhe pregatitjen e raporteve per rregullatorin direkt nga regjistrimet/llogarite e Kompanise se Prodhimit ne USOA.